



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENIT  
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"MAXHI ZEKA"



UNIVERSITETI I MITROVICËS  
ISA BOLETINI



UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"



UNIVERSITETI I GJAKOVËS  
FEHMI AGANI



UNIVERSITETI  
I SHKENCAVE TË APLIKUARA  
FERIZAJ

Prishtinë, 19 nëntor 2019

## Konferenca e Rektoreve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës

### KOMUNIKATË

Konferenca e Rektorëve e Universiteteve Publike të Kosovës ka mbajtur më datë 19 nëntor 2019, mbledhje të jashtëzakonshme, ku ka diskutuar për rrjedhën në arsimin e lartë në Kosovë, veçanërisht për presionin e shantazhet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë ndaj universiteteve publike.

Rektorët njëzëri kanë shprehur indinjatë të thellë për gjuhën kërcënuese, shantazhuese dhe pa etikë të ministrit të MASHT, Shyqiri Bytyqi, në shkresën me numër 195/01B drejtuar rektorit të UShAF, Prof.Dr. Agron Bajraktari.

Diskursi i përdorur në këtë shkresë është për keqardhje dhe dëshmi se sa kanë degraduar politikat arsimore në qeverinë e Kosovës dhe sa kanë devijuar partitë politike në trajtimin e arsimit e të kuadrove të arsimit.


Konferenca e Rektorëve thekson faktin se kjo nuk është hera e parë që Ministri tejkalon kompetencat e veta, duke ndërhyrë në autonominë e universiteteve publike. Prej se është zgjedhur ministër z. Bytyqi ka udhëhequr një politikë institucionale e jo institucionale kundër universiteteve publike.

Ndërhyrjet e Ministrit të Arsimit në universitetit publike i dëmtojnë përpjekjet tona të mëdha për të ngritur cilësinë në arsimin e lartë publik dhe i bëjnë dëm të vazhdueshëm Kosovës në ndërkombëtarizimin e arsimit, ashtu siç edhe është dëshmuar tashmë me përjashtimin nga organizata shumë të rëndësishme evropiane.

I garantojmë të gjithë hisedarët e arsimit të lartë, sidomos studentët, profesorët dhe administratën e universiteteve publike, por edhe hisedarët e tjerë jashtë universiteteve, se asnjë politikë dashakeqe e asnjë ministri nuk do të mund të dëmtojë autonominë e universiteteve publike dhe lirinë akademike, të garantuar me ligj.

**Bashkëngjitur gjeni shkresën me nr. 195/01B të ministrit Bytyqi dhe përgjigjen me nr. 4128/19 të rektorit Bajraktari.**

Prof. Dr. Fadil Millaku, rektor i UHZ-Pejë

  
Kryesues i Konferencës së Rektorëve